



Dalës-Izlezna

Nr. -1-95  
Br.

Data 19.07.2023  
Datum

OBILIC-OBILIĆ



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC**

**KUVENDI KOMUNAL OBILIQ**

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.30.06.2023, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Sami Ahmeti (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Valon Svirca (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

**Të pranishmit tjerë:** Ibush Mjekiqi, Nënkryetar i Komunës, drejtorët komunal, Daut Mjeku, shef i sektorit për ekonomi, Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun dhe Arta Mjeku, zyrtare përkthim të qëndrueshëm

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

**R E N D D I T E**

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së DEFZH-së, për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa Ngarkesa dhe Gjoba Komunale nr.05/2022, të dt.26.10.2022, sipas sugjerimit të Ministrisë së linjave
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së DSHMS-së, nr.-VIII-174, të dt.12.06.2023, për dhënien në debat publik të Planit Komunal për Ri Integrin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Obiliqit 2023-2025
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së DAP-së, nr..-III-156, të dt.16.06.2023, Raporti për zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në Komunën e Obiliqit 2022
6. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.-II-770, të dt.16.06.2023, lidhur me Peticionin nga banorët e lagjes "Miniera" Obiliq
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024 dhe vlerësimet përvitet 2025 dhe 2026
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 19 vota për.

**Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal ishin të pranishëm.

**Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohen ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara me 18 vota për.

**Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën e DEFZH-së, për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa Ngarkesa dhe Gjoba Komunale nr.05/2022, të dt.26.10.2022, sipas sugjerimit të Ministrisë së linjave.

**Enver Gashi** – Ne jemi për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 18 vota për e aprovuan Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa Ngarkesa dhe Gjoba Komunale nr.05/2022, të dt.26.10.2022, sipas sugjerimit të Ministrisë së linjave.

**Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën e DSHMS-së, për dhënien në debat publik të Planit komunal për Riintegrin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Obiliqit 2023-2025.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 20 vota për e aprovuan Vendimin për për dhënien në debat public të Planit komunal për Riintegrin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Obiliqit 2023-2025.

**Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën e DAP-së, raportin për zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në Komunën e Obiliqit, 2022.

**Enver Gashi** – Unë veç kam qenë pjesëmarrës me disa anëtarë të Kuvendit në Komisionin për zgjedhjen e Këshillave të fshatrave dhe ne sot e morëm edhe një raport zyrtar, kështu që nuk kemi çka të shtojmë. Mirëpo, nëse dikush ka drejtoreshën e kemi prezantë dhe mund ta elaboroj në pika të shkurtëra krejtë procesin.

**Ajet Berisha** – Raporti ishte korrekt për mua, por në fakt veç u vërejtë një padrejtësi në shpërndarjen e të dhënies së drejtës për me u bë në grumbullim të fshatrave, po e marrë shembull konkretisht i keni futë 2 Mazgitat, Shkabaj, Hade e Re, e keni lënë Dardhishtën vetëm. Pra, është një ndarje jo e mirë proporcionale sepse numri i banorëve që përfaqësojnë në këtë ndarje është shumë më i madh, vetëm Mazgiti me qenë ose i Dardhishtës, jo i keni shtue Shkabaj, e keni shtue Hade e Re, në vend se atë me ngjitë me Dardhishtën. Ndoshta, vetëm pse është fshati i Enverit aty, e keni lënë atë vetë do të thotë është pak e çuditshme kjo ndarje, përndryshe raporti është korrekt.

**Enver Gashi** – Nuk është vetëm fshati i Enverit, por ky Kuvend e ka aprovue se fshati Dardhishtë gjeografikisht është më largë me fshatin Shkabaj ose Mazgiti, veç ngjitet me Shkabaj dhe me nisë me marrë me numër të banorëve atëherë në Obiliq, është dashur me i bë afér 5 Këshilla të fshatit. Rastin konkret e ke Baimocin që është me shumë më pak banorë, është Shipitulla me Grabofcin që i ka më pak banorë, do të thotë është ndarë njëherë dhe ka mbetë, ky Kuvend e ka aprovue atë ndarje. Prandaj, nuk është punë e Enverit, por fshati Dardhishtë, është më largë me fshatin Shkabaj se Mazgiti dhe kjo është arsyaja.

**Ajet Berisha** – E di që Kuvendi, por e ka miratuar gabim për mua sepse edhe fshati Dardhishtë dhe Mazgit kufizohet me Shkabaj, kështu që më largë apo më afér kufizohet. Në thelb proporcionalisht është dashur të bëhet ndarja ndryshe, që për mua ka gabuar Kuvendi.

**Ibush Mjekiqi** – Në bazë të Udhëzimit administrativ, ne është dashur të formojmë 12 Këshilla komunale dhe tash a ka votuar Kuvendi gabim, apo jo është munduar të bëhet një zgjidhje më e mirë e mundshme dhe kjo ka qenë arsyaja, e jo arsyje të tjera.

**Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti shqyrtimin e kérkesës së Kryetarit të Komunës, lidhur me peticionin nga banorët e lagjes “Miniera” Obiliq.

**Enver Gashi** – Si Kuvend jemi të obliguar që kérkesën lidhur me peticionin ta shqyrtojmë, materialin e kemi marrë që e ka dhënë kompania për realizimin e nënkalimit dhe ne qëndrojtmë para raportit profesional që e kanë dhënë, kështu që jemi të kaloj ashtu qysh e ka dhënë kompania. Unë personalisht jam inxhinjer, por jo inxhinjer i ndërtimit dhe tash me thënë bën kështu, e bën ashtu kur veç e kemi një raport profesional të kompanisë.

**Ajet Berisha** – Për mua, profesionistët japidin mendim në bazë të kérkesës që shtron dikush. Tani, me thënë se nuk ka mundësi me u bë një nënkalim në këto rrethana, në këto arritje shkencore që janë bë, ne mund të themi nuk kemi mjete, nuk kemi mundësi sot, nuk do të kemi mundësi kurrë se jeni parashikues të mirë. Mirëpo, me thënë se ekspertët e kanë dhënë mendimin se kjo nuk mund me ndodhë, atëherë kjo është mungesë e njoburive për zhvillimet që janë bë. Sot po zgjatin tunele nëpër dete, po bëjnë tunele të mëdha dhe një nënkalim nën një hekurudhë, një mbikalim mbi hekurudhë ekspertët po e ndalojnë, do të thotë vetëm ju dini me nxjerrë këso raporte. Singersiht njëqind argumentime tjera, mund ti keni me thënë se në mungesë buxhetore, vështirësi në planifikim, duhet shpronësim, do të thotë që disa janë përmendë këtu, por me thënë nuk bëhet kanë thënë ekspertët ky raport për mua është i pavlefshëm. Prandaj, kjo është mungesë e seriozitetit të këtij Ekzekutivi për me iu qasë drejtë kérkesës së qytetarëve dhe këtij problemi që kanë qytetarët në atë lagje. Edhe jo që nuk duhet me u përkrahë ky peticion në këtë formë qysh është dhënë përgjegja, por është deri te amatere sepse me thënë nuk ka zgjidhje, e kjo ka zgjidhje gjithqysh sot zgjidhje mund të gjendet o mbikalim, o nënkalim, o me pompa, o pa pompa. Unë hiç nuk marrë vesh në këtë punë, por me një mendim të thjeshtë këtë e din edhe naivi më i madh mund me kuptue, që kjo nuk është e saktë, ky vlerësim që është dhënë këtu.

**Sami Ahmeti** – Tani, kjo kérkesa për nënkalime të automjeteve dhe këmbësorëve, që ka ardhë prej qytetarëve të asaj lagjeje, do të thotë nuk është kérkesa e parë, por janë disa kérkesa dhe më duket edhe 2 prej këtyre kérkesave i kemi shqyrtue në 2 seanca paraprake. Mirë që ky peticion ka arritë me ardhë deri në Kuvend dhe unë aq sa munda me zënë pjesën e bisedës kam vërejtë se është kérkesa e qytetarëve, që kanë kërkue për nënkalime për vetura, e rrjedhimisht që do të shërbën edhe për udhëtarë apo këmbësorë. Në ndërkohë përgjegja e Drejtorisë së infrastrukturës lokale është se ajo do të bëhet vetëm për këmbësorë për arsyet e ujërave nëntokësore, ujërave sipërfaqësore, apo kanalizimet fekale e të gjitha, çka unë mendoj se në në këtë kohë kur ndërtohen tunele qindra kilometërshe nëndeti, e nuk ka mundësi me u bë një nënkalim, është e çuditshme. Sido që të jetë, ne i mbështesim kérkesat e qytetarëve dhe ata qytetarë me të drejtë e kanë brengë atë çështje të atij nënkalimi dhe lidhjes së qytetit, por me aq sa unë kam parë këtu, mungon një pjesë që është pjesa kryesore, është pjesa e pronësisë dhe pjesa e asaj që do të duhej të përgjegjet Infrakosi. Unë me sa kam marrë informata brenda kësaj kohe së paku në 3 adresë, në Ministrinë e infrastrukturës, në Ministrinë e ekonomisë dhe në Infrakos deri më tanë Komuna e Obiliqit, nuk ka ofrue asnjë plan, asnjë projekt, asnjë kérkesë për nënkalime të tilla. Me thënë kam informacion, me keqardhje ju informoj se as nënkalim për këmbësorë, as për automjete Infrakosi nuk do të lejoj sepse ky është një projekt i Bashkimit Evropian (BE) i cili më nuk ka kohë të ndryshohet për arsyet se në vitin 2019, Komuna ka pasë kohë me ofrue projekt për këto nënkalime. Atëherë, nuk është ofrue nuk ka pasë vullnet apo nuk ka pasë dije dhe mua më vjen shumë keq që çfarëdo që do të votojmë sot, çfarëdo vendimi që do të nxjerrim sot mendoj se do të jetë i pavlefshëm. Sido që të jetë neve na ka ardhë e këtë dokument që na është ofrue, është kérkesa e qytetarëve që kërkojnë nënkalim për automjete e rrjedhimisht edhe për këmbësorë, është përgjegja e Drejtorisë vetëm për këmbësorë. Unë kërkoj nga ju që në rast se votohet diçka të vendosen si të tilla kérkesa e qytetarëve për vetura dhe këmbësorë, e pastaj përgjegja e Drejtorisë. Për kérkesën e parë të qytetarëve ne si grup i LVV-së, jemi pro ndërsa për përgjegjen e dytë do të abstenojmë.

**Ibush Mjekiqi** – Problematika e ndërtimit të nënkalimeve, nuk është e tanishme dhe nuk është iniciativë vetëm e qytetarëve. Mirëpo, edhe në bisedimet që i ka zhvillue Kryetari i Komunës lidhur me pjesën e

ndërtimit të hekurudhës, që nënkupton pjesën e dytë prej Fushë Kosovës deri në Mitrovicë, ka ndodhë brenda këtyre 3,4 viteve dhe është bërë edhe kjo. Varet se me kend ka bisedue z.Ahmeti, apo dikush tjetër dhe kanë marrë informacione, do të thotë këto janë shqyrtue edhe në zyrat tona këtu, por edhe në zyrat e Drejtorisë së Infrakosit në Fushë Kosovë. Vullneti ynë është për ndërtimin e tyre, por ne nuk mund ta bëjmë në bazë të vullnetit sepse duhet bërë matje dhe ky studim i fizibilitetit është bërë. Është ardhë në konstatim se niveli i ujërave nëntokësore është deri në 3.4 metra, që nënkupton se nuk lejohet ndërtimi i një nënkalimi të tillë. Eshtë e vërtetë, se ka edhe probleme pronësore, por problemet pronësore unë personalisht i shohë më të vogla se sa problemin e ujërave nëntokësore. Prandaj, Ekzekutivi në krye me Kryetarin kanë ndarë në fillim të këtij viti 400,000 euro, dhe bazuar në matjet është ardhë në përfundim se nuk mund të ndërtohet nënkalimi për vetura që nënkupton në lartësi 4.7 deri në 5.2 metër. Mirëpo, kemi ardhë në përfudnim dhe kemi vendosë të ndërtojmë 2 nënkalime për këmbësorë, por jo edhe për vetura sepse nuk mund të kalojnë veturat, mirëpo vetëm këmbësorët dhe lartësia mund të jetë dikund 2.5 deri në 3 metra. Prandaj, ky është vendimi ynë në bazë të matjeve gjeomekanike dhe kushteve teknike të terrenit. Z.Sami, e shtroi një pyetje te nënkalimet se nuk lejon hekurudha e ndërtimit dhe ne në bazë të takimeve që i kemi pasë kemi kërkuar me shkresë pëlqimin për ndërtimin e 2 nënkalimeve. E kemi marrë pëlqimin pastaj, kemi fillue me hartimin e projektit. Pëlqimin të cilin e kemi marrë për 2 nënkalime prej hekurudhës kemi paguar taksë dikund afér 2,000 euro. Pra, kushtet teknike ekzistojnë për ndërtimin e tyre ndërsa, gjithçka tjetër është spekulim z.Sami, që nuk di prej nga i ke marrë informatat, por ne i kemi pëlqimet prej hekurudhës, që lejohet ndërtimi i 2 nënkalimeve të planifikuara nga ana jonë.

**Sami Ahmeti** – Do të ishte mirë të na ofrohen ato pëlqime. Unë në fakt uroj të jetë ashtu, por informatat që i kam prej Bordit të Infrakosit, na kanë thënë se nuk ka kurrfarë mundësie me prekë më në projekt sepse është projekt i miratuar prej BE-së, dhe nuk lejon asnjë ndryshim, që ka qenë dashtë kësaj kërkese ti bashkangjitet. Ne i gjëzohemi çfarëdo lidhje që bëhet e qytetit në fund të fundit edhe për këmbësorë, por arsyet që janë ofrue dhe dokumentet nuk janë nënshkrue si të tilla. Derisa nuk kemi dokumente, unë kam kërkuar prej andej dhe andej më kanë thënë se nuk ka ndonjë projekt sepse shumë pozicione të punëve, veç janë krye dhe tash nuk ka mundësi përsëri me gjërrye dhe me prish atë pjesë, që është bërë. Unë kështu kam informata, uroj të jetë ashtu siç thoni ju. Jo, dezinformata, por unë vetëm kam marrë informata dhe e kam brengë këtë punë.

**Ibush Mjekiqi** – Unë kërkoj nga Drejtoria e infrastrukturës mundësish me na sjellë pëlqimin prej hekurudhës sepse vetë i kam nënshkrue pagesat për marrjen e këtyre pëlqimeve dhe jam shumë i sigurtë në këtë që po e them. Ndërhyrja ka mundësi sepse e kanë dhënë pëlqimin dhe dinamika e punimeve prej fillimit te kjo pjesë e hekurudhës prej Fushë Kosovës, deri në Mitrovicë, ka 455 ditë, dinamikë të punimeve

**Arben Berisha** – Sa i përket kësaj, kam qenë edhe në takim me Kryetarin dhe tash flasim për një kompani që është e licencuar me të gjitha parametrat dhe normat që parashihen nga shteti. Flasim për disa informata që ndaç thuaj të rrugëve, ndaç thuaj të kujt do qoftë, të pavërtetuara dhe me u marrë me ato më duket e paarsyeshme. Edhe si Bord i drejtoreve, ua kemi kthyer përgjegjen në bazë të dhënavë se nuk lejohet për shkak të reshjeve atmosferike. Ne i kemi edhe 2 nënkalime, që i kemi shembull në rrugën M2 që i ka vendos Ministria në atë kohë dhe të dyjat janë të pashfrytëzuara, Atë që e thonë parafolësit ne kemi edhe ura nëndeti, por nuk është mundësia dhe kostoja nuk e përballon për një nënkalim që e kemi edhe mbikalimin dhe e kemi kalimin me barierë. Kuvendarëve, ju kisha sugjeru që kuptimin e drejtë dhe të kompanisë që është e licencuar dhe e merrë barrën për këto gjëra të mbetet vendimi i kompanisë. Nuk votohet peticioni i qytetarëve, tash me fjalë të rrugëve me u marrë Kuvendi dhe Drejtoria, nuk më duket e arsyeshme.

**Kryesuesja** - Besoj se u shpjegua shumë qartë nga Nënkryetari çështja e peticionit, madje edhe mjetet financiare.

**Ajet Berisha** – Kryesuese, është mirë njerëzit e tillë, me fjalor të tillë që po më vjen edhe keq me reague çdo herë për njerëz me një naivitet të tillë, me një njeri kaq të pacipë se ka rrugaq, fjalë të rrugëve.

Seancën e Kuvendit, e lëshojnë këta anëtarë: Ajet Berisha, Valbonë Beka, Sami Ahmeti, Ajshe Haliti Pllana, Valon Svirca, Albana Shillova Shalaku, Linda Sadiku Krasniqi dhe Samire Berisha.

**Arben Berisha** – Unë nuk e di çka e preku, por nëse e ka mizën pas veshit, e ka çka kam me i bë. Kryesuese unë dua ta paraqes shqetësimin tim, një rrugaç i jepet hapësirë sa don ai e merrë fjalën me zor e pa zor ndërsa, ne si Ekzekutiv nuk mundemi me pasqyrue gjendjen tonë. Thirret për fjalë të rrugëve, ndërsa ne flasim për një kompani me licencim me autoritetin që e ka përcaktue shteti. **Kryesuesja** - Mendoj se shumë mirë e shpjegoj Nënkyetari madje i solli edhe dëshmitë që me u bind me fakte se gjithçka jemi në rregullë. Të nderuar anëtarë të Kuvendit, kërkoj falje për gjithë këtë që u shkaktue.

**Ibush Mjekiqi** – E drejta e qytetarëve është me bë kërkesa të ndryshme, që nuk e përjashton mundësinë se nuk kanë të drejtë, do të thotë kanë të drejtë. Pastaj, veprimet të cilat bëhen nga Kryetari bashkë me Ekzekutivin konstatohet se a mund të bëhet një veprim në bazë të kérkesës së tyre, apo jo. Pra, konstatuar sipas peticionit të banorëve të lagjes Miniera, nën hekurudhë nuk e përjashton mundësinë se nuk kanë të drejtë, do të thotë kanë të drejtë, por kushtet teknike nuk lejojnë ndërtimin e nënkalimit për vetura. Prandaj, vendimi ynë është që të ndërtohet vetëm nënkalimi për këmbësorë. Ky Kuvend duhet të nxjerrë vendim në bazë të studimit nga kompania e specializuar për këtë punë.

**Xhelal Krasniqi** – Pyeti cila është data e kérkesës.

**Kryesuesja** – Përgjegjet 26.06.2023, ndërsa numri i protokolit është II-770 është kérkesa e Kryetarit.

**Ibush Mjekiqi** – Ne me dt.3 mars kemi bërë kérkesë për Drejtorinë e Infrakosit, pastaj janë marrë të gjitha pëlqimet e mëvonshme. Ja pagesa për 2 nënkalime sepse këtu kam qenë i fundit që kam nënshkruar dhe gjithçka është e rregulluar në mënyrë administrative

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për e aprovuan Vendimin me të cilin Refuzohet Peticioni me nr.-II-13375/23, i dt.23.05.2023, i paraqitur nga banorët e lagjes Miniera, përmes së cilit kanë kërkuar hapjen e rrugës për qarkullim të automjeteve deri në 3.5 tonë dhe lartësi maksimale 2.50 metra, që lidhë lagjen Minierat me rrugën “Isa Boletini”.

#### **Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kérkesën e DEFZH-së, për shqyrtimin dhe aprovimin e KAB-it, 2024 dhe vlerësimet përvit 2025 dhe 2026.

**Enver Gashi** – Ne jemi për aprovimin e këtij vendimi.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për morën Vendim me të cilin aprovohet (KASH) Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024 (2025-2026).

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Sa i përket vendimit për caktimin e lokacionit të Tregut nga MPHI-ja, kemi shkresën përrishqyrtim të këtij vendimi. Herën e parë ka ardhë se vendimi nuk është i bazuar në ligjin nr.04/L-174 dhe ne e kemi plotësue. Tash kërkohet se nuk lejohet destinim tjetër nga ajo që është paraparë me dokumentet e planifikimit hapësinor, pjesën tekstuale dhe pjesën grafike sipas Ligjit nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor. Drejtori z.Arben Berisha, e ka sqarue shumë mirë se Plani zhvillimor i Komunës së Obiliqit, nr.-I-72, i dt.2.6.2023, e parashevë brenda zonës urbane dhe ka destinim banim në përputhshmëri.

**Enver Gashi** – Ne jemi për që të kaloj ky plotësim ndryshim edhe me Planin zhvillimor para këtij që po aprovohet tash, ka qenë i destinuar ai për ndërtim dhe janë dhënë edhe sqarimet e Drejtorisë.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për e aprovuan Vendimin me të cilin bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Vendimit nr.-I-67, të dt.31.05.2023, për caktimin e lokacionit të ri për rivendosjen e Tregut në Njësinë Kadastrale nr.P-72614055-01885-0, në sipërfaqe prej 5801 m<sup>2</sup> e cila evidentohet në emër të Komunës së Obiliqit, e cila në anën veri lindore ka qasje në rr:”Mentor Dervishaj” ndërsa në anën veri perëndimore ka qasje në rr:”30 Marsi”.

**Kryesuesja** – Paraqiti kérkesën e Hanefi Raqit, nga fshati Mazgit dhe propozimin e DPUPK-së, për emëtimin e rrugës me emrin ”Jakup Raqì”.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për morën Vendim me të cilin aprovohet propozimi i DPUKP-së, për emërtimin e rrugës me emrin "Jakup Raqi" (Kod i ri) në fshatin Mazgit.

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën e Besim Krasniqit nga fshati Mazgit, dhe propozimin e DPUKP-së, për emërtimin e rrugës me emrin Tefik Krasniqi.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për morën Vendim me të cilin aprovohet propozimi i DPUKP-së, për emërtimin e rrugës me emrin "Tefik Krasniqi".

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën e Dafina Krasniqit nga fshati Milloshevë dhe propozimin e DPUKP-së, për emërtimin e rrugës me emrin "Nexhmedin Krasniqi".

Anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për morën Vendim me të cilin aprovohet propozimi i DPUKP-së, për emërtimin e rrugës me emrin "Nexhmedin Krasniqi" në fshatin Milloshevë .

#### Pika 9 e rendi të ditës

**Kryesuesja** – E keni një rekomandim nga Komitetit për komunitete dhe lidhur me këtë drejtori i bujqësisë do të japë një sqarim.

**Bejtullah Mjekiqi** – Kërkesa ka qenë rrith dëmeve të shkaktuara nga vërshimet. Me dt.15, 16 dhe 17 ka pasë shira të mëdha dhe dëme dhe sipas kërkesave Komisioni nga DSHPE-ja, ka dalë për vlerësimë të dëmeve. Ne i kemi pasë 43 kërkesa rrith dëmeve në bujqësi, shtëpia, prona, shtalla e tjera. Ne kemi formuar Komisionin dhe ai Komision që nga dita e hënë do të dalë për shkak se për bujqësi kryesisht kanë qenë në fshatin Baimoc, Breznicë dhe Lajthishtë. Ne nuk kemi mund të dalim me bë vlerësimin derisa uji është tërheqë sepse dëmet shihen dhe më lehtë është me bë vlerësimin. Të gjitha kërkesat që kanë dëme bujqësore, do të dorëzohen në Ministrinë e bujqësisë, ku ata e bëjnë pagesën sepse Komuna jonë nuk ka buxhet për pagesë të dëmeve.

**Xhelal Krasniqi** – Realisht ka dëme edhe në fshatin Hamidi, në livadhe dhe qytetarët janë dëmtuar.

**Bejtullah Mjekiqi** – Është e vërtetë, se edhe në Hamidi dhe në atë pjesën në Lajthishtë rrith lumi Sitnica, ka pasë dëme, por kryesisht janë livadhe, dëme ka edhe te gruri dhe te misri, por derisa është tërheqë uji nuk kemi mund të dalim sepse nuk mund ta bëjmë vlerësimin e dëmeve.

**Faton Beka** – E falenderoj drejtorin e bujqësisë, i cili e ka formuar Komisionin për arsy se ka qenë kërkesë e anëtarëve të Komitetit për komunitete. Vërshimet kanë ndodhë e dëmet janë shkaktue. Shpresoj që Komisioni ta kryen punën e vetë dhe Ministria e bujqësisë, ti kompenzon dëmet që janë bërë.

**Bejtullah Mjekiqi** - Këtu, kemi edhe anëtarë të Kuvendit të cilët e dijnë se në Komunën tonë kurrë nuk ka pasë ndasi dhe dëmi është për të gjithë, kështu që dëmi do të vlerësohet për të gjithë.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:50'**

Bashk.prof.për punë të KK



Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal

